




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE
TË KOMPANISË RAJONALE TË UJËSJELLËSIT HIDROMORAVA
SH. A. PËR VITIN 2021**

Prishtinë, qershor 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Pasqyrat financiare vjetore të audituara

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Kompanisë Rajonale të Ujësjetës Hidromorava sh. a. për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kundërt për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Kompanisë Rajonale të Ujësjetës Hidromorava sh. a. (Kompania), të cilat përmbajnë pasqyrën e pozitës financiare për vitin 2021, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme kontabël, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, për shkak të efekteve të çështjes së përshkruar në paragrafin “Baza për Opinion të Kundërt”, Pasqyrat Financiare të bashkangjitura nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozitës financiare të Kompanisë Rajonale të Ujësjetës Hidromorava sh. a. deri me 31 dhjetor 2021, të performancës së saj financiare, si dhe rrjedhës së parasë së gatshme për vitin 2021, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinion të kundërt

- A1 Me vendim të gjykatës së formës së prerë për 14 raste me vlerë totale prej 34,741€ gjykata pjesërisht kishte shfuqizuar urdhërat përmbartimor, duke i lejuar pagesën vetëm të një pjesë të obligimeve për shkak se lëndët ishin parashkruar sipas Ligjit për Marrëdhënie të Detyrimeve. KRU Hidromorava ka bërë regjistrim të gabuar kontabël duke zbritur të ardhura të vitit 2021 për vlerën 34,741€ në vend se kjo të regjistrohej si fshirje e LLA dhe njohje e shpenzimeve të borxhit të keq;
- A2 Nga 15 letër konfirmime të dërguara për llogaritë e arkëtueshme, kemi pranuar vetëm tri (3) në vlerën financiare 25,428€, ndërsa për 12 të tjera në vlerë prej 152,023€, nga debitorët nuk kemi pranuar fare letër konfirmime. Bazuar në dokumente burimore të ish ndërmarrjeve shoqërore dhe shënimeve në kontabilitet ne kemi vërejtur mospërputhje, përkatësisht në gjashtë (6) raste llogaritë e arkëtueshme ishin mbivlerësuar për 31,484€;
- A3 Kompania nuk kishte aplikuar fare provizionimin e llogarive të arkëtueshme (LLA) në PF të vitit 2021. Saldo e provizionit të LLA nga vitet e më hershme është 4,547,133€ nga totali i LLA bruto prej 8,444,440€ Kompania nuk kishte aplikuar një politikë të përshtatshme dhe konsistente të provizionimit të LLA;
- A4 Gjatë vitit 2021, Kompania kishte hyrë në marrëveshje me Administratën Tatimore duke u dakorduar për shumën e detyrimeve tatimore prej 241,110€, ngjarje të cilën, në kontabilitet e kishte njohur si shpenzim të periudhës, duke shkaktuar mbivlerësimin e shpenzimeve për të njëjtën shumë;

- A5 Kompania kishte prezantuar në pasqyrën e pozicionit financiar pasuritë afatgjata në vlerë 6,802,558€ ndërsa vlera totale e pasurive sipas shënimeve analitike në kontabilitet ishte 6,800,502€. Diferenca prej 2,056€ paraqet shumën e mbivlerësuar për pasuritë afatgjata në pasqyrat financiare.
- A6 Mos aplikimi i duhur i klasifikimit të pasurive kishte ndikuar në nënvlerësim të shpenzimeve të zhvlerësimit për vlerën prej 1,022€.
- B1 Kompania për aktivet afatgjata materiale, procesin e vlerësimit të aseteve për herë të fundit e kishte realizuar në vitin 2007. Vlera a pasurisë me 31.12.2021 që mbahet në regjistrat kontabël sipas modelit të rivlerësimit ishte 6,802,558€ dhe shpenzimet e zhvlerësimit për vitin ishin 610,088 €. Nga gjithsej 2,020 pasuri, prej tyre 1,199 apo 59%, në librat kontabël kishin vlerën zero (0). Në mungesë të një rivlerësimi më të afërt me datën e bilancit të gjendjes dhe rishikimit të jetëgjatësisë së pasurive, ne nuk ishim në gjendje të përcaktojmë nëse pasuritë dhe shpenzimet e zhvlerësimit për vitin 2021 ishin prezantuar saktë dhe drejtë;
- B2 Te llogaria e stoqeve, në shtatë (7) raste në vlerë të përgjithshme prej 28,212€ Kompania kishte përfshirë edhe pajisjet kapitale, të cilat përbëhen nga gjeneratorët, makinat për prerje të asfaltit, aparatet për saldim, aparatet elektrike dhe makinat për prerjen e gypit polietik. Paraqitja e gabuar e këtyre pajisjeve kapitale kishte rezultuar me mbivlerësim të stoqeve në PFV për 28,212€;
- B3 Kompania kishte prezantuar në pasqyrën e pozicionit financiar Të Hyrat e shtyra (detyrime ndaj grantit) në vlerë 5,005,652€ ndërsa sipas shënimeve analitike në kontabilitet ishte 4,588,693€. Diferenca prej 416,959€ paraqet shumën e mbivlerësuar për Të Hyrat e shtyra.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë te pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit të përgjithshëm për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe me kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike dhe Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera të Kompania kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë të përshkruara më poshtë të pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit të Përgjithshëm për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe me kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike dhe Kodit të Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë gjithashtu zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim

Bordi i Drejtorëve është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kompanisë Rajonale të Ujësllësit Hidromorava sh. a..

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Kompanisë Rajonale të Ujësllësit Hidromorava sh. a. është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Kompanisë Rajonale të Ujësllësit Hidromorava sh. a. në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, si dhe të gjitha ligjet, rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.²

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrim një raport të auditimit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është niveli i lartë sigurie, por nuk garanton se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keqdeklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, me arsye pritet që të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre Pasqyrave Financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Kompania Rajonale e Ujësllësit Hidromorava sh.a. me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislati i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare. Si pjesë e auditimit, në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-t, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keqdeklarimit material të Pasqyrave Financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit; hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit konform atyre rreziqeve, si dhe sigurojmë dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të duhura për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i moszbulimit të një keqdeklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për keqdeklarimin që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulimin, falsifikimin, lëshime të qëllimshme, keqpërfaqësime apo anashkalimin e kontrollit të brendshëm.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo me qëllim të shprehjes së opinionit për efikasitet të kontrollit të brendshëm të Kompanisë Rajonale të Ujësjetës Hidromorava sh. a..
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura kontabël dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim nëse baza e vijimësisë së kontabilitetit është e përshtatshme për përdorim nga menaxhmenti, bazuar në provat e siguruar të auditimit, nëse ekziston pasiguria materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të hedhin dyshime të rëndësishme në aftësinë e Kompanisë Rajonale të Ujësjetës Hidromorava sh. a., për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Nëse konkludojmë se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet përkatëse në Pasqyrat Financiare ose, nëse zbulimet e tilla janë të papërshtatshme ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona bazohen në provat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Sidoqoftë, ngjarjet apo kushtet e ardhshme mund të bëjnë që NP-ja të pushojë së vazhduari sipas parimit të vijimësisë.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e Pasqyrave Financiare, përfshirë edhe shpalosjet, për t'u siguruar se Pasqyrat Financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm se deri në çfarë mase ato janë adresuar. Ky raport ka rezultuar me tetë (8) rekomandime të reja dhe katër (4) rekomandime të përsëritura

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 3.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Nënvlërësimi të ardhurave

Gjetja

Sipas SNK 18 paragrafi 21 njohja e të ardhurave bëhet në përputhje me fazën e realizimit, pra në periudhën kontabël kur shërbimi është kryer. Ndërsa sipas IFRS 9 paragrafi 3.2.3 njëra ndër kushtet që njësia ekonomike të çregjistrojë një aktiv është atëherë kur përfundojnë të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktivi financiar. Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, neni 360 paragrafi 1 përcakton se shërbimet e ujësjellësit për konsumatorët shtëpiak-amvisëri janë kërkesa që parashkruhen pas një (1) viti ndërsa sipas nenit 355, Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale parashkruhen për tri (3) vite.

Gjatë auditimit, ne kemi identifikuar se KRU Hidromorava nuk kishte prezantuar në PFV të ardhurat në vlerën e saktë. Me vendim të gjykatës së formës së prerë në 14 raste me vlerë totale 34,741€, gjykata pjesërisht kishte shfuqizuar urdhërat përmbarimor, duke i lejuar pagesën vetëm të një pjesë të obligimeve për shkak se lëndët ishin parashkruar sipas Ligjit për Marrëdhënie të Detyrimeve. Dy nga këto raste me vlerë monetare 3,916€ janë ngjarje të vitit 2021, ndërsa 12 të tjera në vlerë 30,825€ i takojnë viteve të mëhershme.

Ne kemi identifikuar se KRU Hidromorava kishte bërë regjistrim të gabuar kontabël duke zbritur të ardhurat e vitit 2021 për vlerën 34,741€, në vend se kjo të regjistrohej si fshirje e llogarive të arkëtueshme dhe të njihet si shpenzim i borxhit të keq në periudhat respektive kur ngjarjet kanë ndodhur.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i aplikimit të gabuar të regjistrimit kontabël. Ndërsa deri tek parashkrimi i lëndëve kishte ardhur për shkak se Kompania nuk kishte ndërmarrë hapat ligjor me kohë për të parandaluar parashkrimin e borxheve. Tjetër faktor me rëndësi që ka ndikuar që borxhet të parashkruhen është se pagesat e realizuara nga konsumatorët, në sistemin e faturimit nuk identifikohen me faturat përkatëse, por ato zbriten nga borxhi i përgjithshëm, gjë që e pamundëson identifikimin e borxhit të vjetër dhe atij që nuk është subjekt i parashkrimit.

Ndikimi

Regjistrimet e gabuara kontabël kanë ndikuar që ardhurat e vitit 2021 të jenë të nënvlerësuara për 34,741€ dhe si rrjedhojë e saj shpenzimet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse nuk ishin prezantuar saktë. Regjistrimet e tilla reflektojnë edhe në pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhjes së parasë për periudhën. Po ashtu, mos marrja e veprimeve ligjore me kohë për ndalimin e parashkrimit të borxheve ndikon drejtpërsëdrejti në zvogëlimin e të ardhurave për Kompaninë.

Rekomandimi A1

Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë zbatim të plotë të SNK-ve dhe SNRF-ve në përgatitjen e pasqyrave financiare duke bërë korrigjimet adekuate në kontabilitet. Po ashtu, Kompania duhet të ndërmarrë me kohë veprimet ligjore që parandalojnë parashkrimin e borxheve dhe të intervenojë në sistemin e faturimit ashtu që faturat e paguara dhe ato të pa paguara të jenë të identifikueshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Mospërputhje e dokumenteve burimore dhe shënimeve në kontabilitet për ish ndërmarrjet shoqërore dhe pamundësia e konfirmimit të bilanceve të llogarive të arkëtueshme

Gjetja

Sipas Ligjit Nr. 06/L- 032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim neni 12 përkatësisht pika 1 përcakton se: Shoqëritë tregtare që i nënshtrohen dispozitave të këtij Ligji, verifikojnë të paktën një herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmimeve të tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit.

Nga 15 letër konfirmime të dërguara në shumë 177,451€, kemi pranuar vetëm tri (3) në vlerën financiare 25,428€, ndërsa për 12 të tjera në vlerë prej 152,023€, nga debitorët e testuar nuk janë kthyer letër konfirmimet. Nga tri (3) letër konfirmimet që nuk i kemi pranuar për vlerën prej 26,478€, sipas zyrtarëve të kompanisë konsumatorët nuk ekzistojnë ose nuk janë të identifikueshëm për shkak se mungojnë adresat e sakta dhe të dhënat tjera, ndërsa për 12 raste që nuk janë kthyer letër konfirmime, ne kemi kryer procedura alternative për verifikimin e saldove.

Duke u referuar dokumenteve burimore të ish ndërmarrjeve shoqërore dhe shënimeve në kontabilitet, ne kemi vërejtur mospërputhje, përkatësisht në gjashtë (6) raste llogaritë e arkëtueshme në vlerë 31,484€ ishin mbivlerësuar,

Kjo kishte ndodhur për shkak se kompania nuk kishte bërë procesin e inventarizimit-harmonizimit me klientë në baza periodike.

Ndikimi

Rastet kur klientët nuk ekzistojnë apo nuk mund të identifikohej, si dhe rastet kur klientët refuzojnë të nënshkruajnë konfirmimin, rrisin rrezikun që kompania të prezantoj gabimisht gjendjen e llogarive në pasqyra financiare. Rrjedhimisht Kompania mund të mos jetë në gjendje të arkëtojë borxhet e tilla në të ardhmen.

Rekomandimi A2

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë procedura të harmonizimit periodik të llogarive me debitorët. Për ndërmarrjet shoqërore të cilat janë privatizuar, kompania duhet ta diskutoj çështjen e borxheve të pa paguara me Agjencinë Kosovare të Privatizimit e cila ka administruar procesin e transformimit të pronësisë dhe detyrimeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Mos aplikimi i provizionimit të llogarive të arkëtueshme

Gjetja

Sipas SNRF 9 B5.5.35 Instrumentët financiarë, një njësi ekonomike mund të përdorë mjete praktike të volitshme kur mat humbjen e pritshme të kredisë nëse ato janë në përputhje me parimet e paragrafit 5.5.17. Një shembull i një ndihmesë të tillë është llogaritja e humbjeve të pritshme të kredisë për llogaritë e arkëtueshme tregtare duke përdorur një matricë provizionesh. Njësia ekonomike do të përdorë përvojën e saj historike të humbjes së kreditit (e rregulluar sipas nevojës në përputhje me paragrafët B5.5.51-B5.5.52), si një praktikë të përshtatshme, për llogaritë e arkëtueshme tregtare për të vlerësuar humbjet e pritshme të kredisë për periudhën 12-mujore ose humbjet e pritshme të kredisë për tërë jetën për aktivin financiar. Në varësi të larmisë së klientëve të saj, njësia ekonomike do të përdorë grupimet e përshtatshme në qoftë se përvoja e saj historike e humbjeve të kredisë tregon modele të ndryshme humbjeje për segmente të ndryshme të klientëve.

KRU Hidromorava nuk ka aplikuar fare provizionimin e llogarive të arkëtueshme në PF të vitit 2021. Saldo e provizionit të LLA nga vitet e më hershme është 4,547,133€ nga totali i LLA bruto prej 8,444,440€. Kompania nuk ka aplikuar një politikë të përshtatshme dhe konsistente të provizionimit të LLA. Vlen të theksohet se nga saldo e përgjithshme e LLA bruto në vlerë prej 8,444,440€, borxhe më të vjetra se 1 vit janë 7,810,886€ apo 92% e tyre, e që potencialisht mund të trajtohen si borxhe të parashkuara.

Mos aplikimi i provizionimit të LLA për vitin 2021 kishte ndodhur për shkak se menaxhmenti nuk kishte adaptuar politika për provizionim të llogarive të arkëtueshme.

Ndikimi Mos aplikimi i provizionimit të LLA sipas një analize të qëndrueshme që mat humbjen e pritshme të kredisë, mund të sjellë deri te mbivlerësimi material i LLA në pasqyrën e pozicionit financiar apo në rastin e kundërt, në nënvlerësimin e shpenzimeve të borxhit të dyshimtë në pasqyrën të ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhën. Rrjedhimisht kjo reflekton edhe pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet për periudhën si dhe pasqyrën e rrjedhjes së parasë.

Rekomandimi A3 Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë zbatim të plotë të SNK-ve dhe SNRF-ve në përgatitjen e pasqyrave financiare ashtu që të vendosë një politikë të përshtatshme për provizionimin e llogarive të arkëtueshme, sipas kërkesave të SNRF në fjalë. Po ashtu, kompania duhet të aplikojë një rishikim gjithëpërfshirës dhe detal të strukturës së LLA për një evidentim dhe pasqyrim sa më të drejtë të tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Mbivlerësimi i shpenzimeve të periudhës

Gjetja SNK 1, paragrafi 68, liston zërat për të cilët informacioni duhet paraqitur në Bilancin Kontabël (Bilancin e Gjendjes) ndër të tjera llogarite e pagueshme tregtare dhe tjera përfshirë detyrimet dhe aktivet për tatimin në të ardhurat. Më specifikisht Llogaritë “Tatimi i Vlerës së Shtuar (TVSH) e pagueshme” dhe Detyrimi për Tatimin në të Ardhurat” janë llogari të detyrimeve afatshkurta në Bilancin e gjendjes. Me tepicën kreditore të këtyre llogarive, tregohet detyrimi i papaguar ndaj shtetit për TVSH-në dhe Tatimin në të Ardhurat.

Kompania gjatë vitit 2021 kishte hyrë në marrëveshje për pagesën e borxheve tatimore me këste ndaj ATK-së. Me këtë marrëveshje borxhi i përgjithshëm ishte përcaktuar në 241,110€ që përfshinte detyrimet ndaj TVSH-së, Tatimit në të ardhurat e korporatave, gjobat dhe ndëshkimet. Kompania pas pranimit të borxhit kishte korrigjuar në kontabilitet detyrimet tatimore duke i rritur konform marrëveshjes, mirëpo të njëjtën shumë e kishte njohur gabimisht edhe si shpenzim të periudhës në pasqyrën e të ardhurave, duke mbivlerësuar shpenzimet e periudhës për shumën prej 241,110€.

Kjo kishte ndodhur si shkak i njohjes se gabuar të detyrimeve tatimore sikur shpenzime të periudhës.

Ndikimi Njohja e detyrimeve tatimore edhe si shpenzime të periudhës nuk është ne përputhje me SNK1, ka ndikim në mbivlerësimin e shpenzimeve dhe njëkohësisht në rezultatin financiar të periudhës. Përveç kësaj mund të ketë edhe ndëshkime nga autoritetet tatimore për njohjen e pasaktë të shpenzimeve.

Rekomandimi A4 Bordi i Drejtorëve duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprime përmirësuese që shpenzimet prezantohen në pasqyrat financiare në përputhje me kërkesat e SNK 1.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Mos përputhje në mes vlerës së pasurive afatgjata të prezantuara në pasqyrat financiare me shënimet në kontabilitet**Gjetja**

SNK 1, paragrafi 30, thekson se Pasqyrat financiare rezultojnë nga përpunimi i një numri të madh transaksionesh ose ngjarjesh të tjera të cilat grupohen në klasa në përputhje me natyrën ose funksionin e tyre. Faza finale e procesit të bashkimit dhe klasifikimit është paraqitja e të dhënave të përmbledhura dhe të klasifikuara, të cilat formojnë zëra në bilancin e gjendjes, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e fluksit monetar, ose në shënimet shpjeguese. Si rrjedhojë vlera totale e shënimeve analitike në kontabilitet për një zë të caktuar duhet të përputhet me vlerën e zërit përkatës të prezantuar në pasqyrat financiare.

Kompania kishte prezantuar në pasqyrën e pozicionit financiar pasuritë afatgjata në vlerë 6,802,558€ ndërsa vlera totale e regjistrimit të pasurive afatgjata (shënimet analitike në kontabilitet) ishte 6,800,502€. Diferenca prej 2,056€ paraqet shumën e mbivlerësuar për pasuritë afatgjata në pasqyrat financiare.

Kjo kishte ndodhur për shkak se zyrtarët financiar, shënimet në kontabilitet i kishin azhurnuar, por ato të dhëna nuk ishin bartur nga sistemi i kontabilitetit në pasqyrat financiare finale.

Ndikimi

Mos prezantimi i saktë i zërit financiar për pasuritë afatgjata reflekton me pasqyrim të gjendjes jo të drejtë në pozicionin financiar të kompanisë. Po ashtu, rrit rrezikun e njohjes së gabuar të shpenzimeve të zhvlerësimit për vitin.

Rekomandimi A5

Bordi i Drejtorëve të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme që të dhënat kontabël që shënimet analitike të regjistrit të pasurive përputhen me vlerën e zërit financiar të pasurive afatgjata të prezantuar në pasqyrat financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A6 - Llogaritje e gabuar e shpenzimeve të zhvlerësimit****Gjetja**

Në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin 2021, theksohet se kompania për zhvlerësimin e pasurive afatgjata (Prona, pajisjet dhe impiantet) përdor koston historike me metodën lineare. Normat e zhvlerësimit, kompania i ka adoptuar nga Ligji Nr. 05/L-029 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave (TAK), 5% për ndërtesat, 10% për uzinat, lokomotivat etj. dhe 20 % për automobilat, kamionët, mjetet e rënda të transportit etj.

Gjatë ri llogaritjes së shpenzimeve të zhvlerësimit kemi vërejtur se kompania për katër (4) artikuj të pasurive, si: televizor, printer, tavolinë pune dhe softueri i kontabilitetit me kosto totale të blerjes prej 137,050€ dhe zhvlerësim të akumuluar 134,090€ kishte aplikuar gabimisht normën e zhvlerësimit prej 5% në cilin grup hyjnë ndërtesat dhe rrjeti i ujësjetit, në vend të normës së duhur të zhvlerësimit prej 20% ku kategorizohen pajisjet. Efekti për vitin 2021 ishte nënvlerësimi i shpenzimeve të zhvlerësimit për vlerën prej 1,022€.

Kjo kishte ndodhur për shkak se zyrtarët e ndërmarrjes i kishin klasifikuar gabimisht pajisjet në grupin e zhvlerësimit për ndërtesa dhe te rrjeti i ujësjellësit.

Ndikimi

Kalkulimi i gabuar për pajisjet, përveç që ndikon në pasaktësinë e shpenzimeve të zhvlerësimit për vitin, rritë rrezikun edhe të ndëshkimeve nga autoritetet tatimore për mos llogaritje të saktë të shpenzimeve të zhvlerësimit sipas grupeve të caktuara.

Rekomandimi A6

Bordi i Drejtorëve të sigurojë, se janë ndërmarrë veprimet korigjuese për njohjen e saktë të shpenzimeve të zhvlerësimit sipas normave të grupeve përkatëse dhe se politika e adoptuar për zhvlerësim të pasurive të ndiqet me konsistencë nga kompania.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B1 - Mos kryerja e rivlerësimit të pasurive****Gjetja**

SNK 16, paragrafi 29, thekson se nëse njësia ekonomike zgjedh modelin e rivlerësimit atëherë, rivlerësimet do të bëhen në mënyrë të rregullt të mjaftueshme që të sigurohet se vlera kontabël (neto) e aktivitetit nuk ndryshon materialisht nga ajo që do të përcaktohej nëse do të përdorej vlera e drejtë në fund të periudhës raportuese.

Frekuenca e rivlerësimit varet nga ndryshimet në vlerën e drejtë të zërave të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) që rivlerësohen, nëse aktiviteti nuk pësojnë ndryshime të rëndësishme dhe të shpeshta në vlerën e drejtë, rivlerësohet zëri vetëm çdo tre ose pesë vjet.

Procesin e vlerësimit të pasurive kompania për herë të fundit e kishte realizuar në vitin 2007. Si rezultat i kësaj në regjistrin e kontabël të pasurive figurojnë 2,020 pasuri ku 1,199 prej tyre janë zhvlerësuar në tërësi. Pra, vlera neto e tyre në librat kontabël ishte zero për 59% të pasurive të evidentuara sipas regjistrin.

Edhe pse këto pasuri ende janë aktive, për to nuk ishte bërë rivlerësimi dhe rishikimi i jetëgjatësisë së tyre prej 14 vitesh, andaj ne nuk ishim në gjendje që të konstatojmë nëse vlera e tyre ishte e saktë apo e nënvlerësuar.

Vlera a pasurisë që mbahet në regjistrat kontabël sipas modelit të rivlerësimit ishte 6,802,558€ dhe shpenzimet e zhvlerësimit për vitin ishin 610,088€.

Ndonëse për këtë çështje rekomandim ishte dhënë edhe në vitet paraprake, kompania për shkak të vështirësive financiare nuk kishte arritur të zbatoj procesin e rivlerësimit, dhe rrjedhimisht rekomandimi nuk ishte zbatuar.

Ndikimi

Mos kryerja e rivlerësimit të pasurive dhe mos rishikimi i jetës se dobishme të aktiveve të cilat veç se janë në përdorim, rritë rrezikun që vlera kontabël e tyre e prezantuar në pasqyra financiare, të jetë materialisht e ndryshme nga vlera e drejtë.

Rekomandimi B1 Bordi i Drejtorëve të sigurojë një rishikim gjithëpërfshirës të regjistrit të pasurisë dhe të ndërmarrë veprime për rivlerësimin dhe rishikimin e jetës së dobishme të pasurive së paku një herë në pesë (5) vite.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Mbivlerësimi i regjistrit të stoqeve dhe mungesa e dokumenteve burimore

Gjetja Sipas SNK 2, paragrafi 6 përcakton se: stoqet janë aktive që mbahen për shitje në rrjedhën normale të biznesit, mbahen në procesin e prodhimit për shitje, ose formën e materialeve ose furnizimeve që konsumohen në procesin e prodhimit ose në dhënien e shërbimeve.

Gjatë auditimit të stoqeve kemi identifikuar se regjistri i stoqeve nuk ishte i saktë për faktin se kompania kishte njohur si stoqe edhe pajisjet kapitale si gjeneratorët, makinat për prerje të asfaltit, makinat për saldimin e gypave polietik, aparate salduese dhe aparate elektrike. Vlera e përgjithshme klasifikimit të gabuar të pajisjeve në stoqe ishte 28,212€. Këto pajisje kanë jetëgjatësi mbi një vit dhe vlerë individuale me të madhe se 1,000€ prandaj plotësojnë kushtin që të njihen si pasuri kapitale. Për më tepër, për këto pajisje mungonin dokumentet burimore.

Kjo kishte ndodhur për shkak të aplikimit të gabuar të SNK 2 me rastin e blerjeve të pajisjeve kapitale, ndërsa sipas zyrtarëve të kompanisë për shkak të ndërrimit të softuerit të kontabilitetit në vitin 2014, këto pajisje janë bartur si saldo dhe tanimë e kanë të vështirë të gjejnë fletëhyrjet dhe dokumentet përcjellëse burimore për t'i regjistruar si pasuri.

Ndikimi Mos klasifikimi i drejtë dhe me kohë i blerjes së pajisjeve ka rezultuar me mbivlerësim stoqeve përkatësisht nënvlerësim të pasurisë kapitale dhe shpenzimeve të zhvlerësimit.

Rekomandimi B2 Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se regjistrimi i stoqeve bëhet në pajtim me kriteret dhe politikat kontabël, dhe të heq nga evidencat pajisjet që duhet të trajtohen si pasuri.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Mos përputhje e evidencave kontabël të granteve me Pasqyra financiare

Gjetja Njëra nga metodat e paraqitjes së granteve në kontabilitet sipas SNK 20 Kontabiliteti i Granteve Qeveritare dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese, paragrafi 26 njihet si të ardhur të shtyrë e cila njihet si e ardhur në një mënyrë sistematike dhe racionale gjatë jetës së dobishme të aktivitetit.

Vlera e të hyrave të shtyra nga grantet (detyrimet ndaj grantit) e paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar 2021 ishte 5,005,652€ ndërsa sipas shënimeve analitike të vlerës së mbetur të pasurive dhe investimeve në vijim të përfituara nga grantet ishte 4,588,693€, që rezulton me një diferencë prej 416,959€.

Kjo diferencë kishte rrjedhur nga saldot e bartura prej viteve të kaluara, dhe gjatë kohës së ekzekutimit të auditimit zyrtarët e kompanisë nuk ishin në gjendje të identifikojnë se cila ishte vlera e saktë.

Ndikimi

Mospërputhje të tilla mund të shfaqin pasaktësi në prezantimin e detyrimeve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar.

Rekomandimi B3

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se vlera e detyrimeve të njihet dhe prezantohet saktë në PFV si dhe të marrë masat e nevojshme korrigjuese të gabimeve në lidhje me detyrimet në të dhënat kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Shpenzimet operative

Shpenzimet vjetore operative të Kompanisë ishin 2,048,985€. Ato kanë të bëjnë shpenzimet personelit, shpenzimet e derivateve, material administrativ, shpenzimet e mirëmbajtës, telefonisë etj.

Çështja A7 - Nënshkrimi i kontratës me vlerë shumë më të madhe se vlera e parashikuar

Gjetja

Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit publik RRUOP, përkatësisht neni 13 Parashikimi i vlerës dhe klasifikimi i kontratës përcakton se: Vlera e parashikuar e një kontrate publike duhet të parallogaritet para inicimit të procedurës së prokurimit. Parallogaritja e tillë duhet të jetë e arsyeshme dhe reale për kontratën e parashikuar nga aspekti i efikasitetit, efektivitetit të kostos, dhe përdorimit transparent dhe të drejtë të fondeve dhe resurseve publike. Po ashtu paragrafi 44.6 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave mund të anulohet për arsye të mëposhtme: të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK.

Tutje, në nenin 8.7 theksohet se personat që kanë autoritet të nënshkruajnë kontratat janë të obliguar, para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, të ri konfirmojnë që informatat financiare (DNPDF) nuk kanë ndryshuar në mënyrë substanciale.

Kompania me datën 02.04.2021 kishte lidhur kontratë publike kornizë për projektin “Furnizim me Stabilimente Elektrike (Pompa, Elektromotor dhe Pajisje përcjellëse” në shumë 229,229€. Ne kemi identifikuar se kompania në planin e prokurimit vlerën e parashikuar të kontratës publike e kishte parallogaritur në shumë 25,000€ dhe mbi bazën e kësaj vlere e kishte iniciuar edhe procedurën e prokurimit. Vlera e parashikuar e kontratës nuk ishte përcaktuar siç e parasheh rregullativa ligjore mbi bazën e arsyeshme dhe reale për kontratën e parashikuar. Prandaj si rrjedhojë e saj oferta nga operatori ekonomik ishte shumë më madhe se sa vlera e parashikuar. Edhe përkundër këtij fakti, kompania nuk e kishte anuluar procedurën e prokurimit edhe pse buxheti i kompanisë ishte dukshëm më i ulët se vlera e parashikuar.

Vlen të theksohet se Deklarata e nevojave dhe disponueshmërisë së fondeve (DNDF) ishte nënshkruar me vlerë të parashikuar prej 25,000€.

Sipas zyrtarëve të kompanisë, mospërputhjet në mes vlerës së parashikuar dhe vlerës së kontratës ishte për shkak se njësisia kërkuese kishte përfshirë pothuajse të gjitha llojet e pompave dhe elektromotorëve të cilat nuk pritet që të gjithat të zëvendësohen gjatë dy (2) viteve sa zgjatë kontrata.

Ndikimi

Nënshkrimi i kontratës me vlera më të mëdha se sa vlera e parashikuar, rritë rrezikun që kompania të hyjë në obligime kontraktuese pa mbulesë financiare, të cilat mund ta ekspozojnë kompaninë para vështirësive për pagesën e obligimeve.

Rekomandimi A7 Bordi i Drejtorëve duhet të siguroj që në rastet e furnizimeve të tilla të përcaktohen sasitë indikative të furnizimeve në mënyrë që vlera e parashikuar e kontratës të jetë e arsyeshme dhe reale, dhe më pas të inicioj procedurat e prokurimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A8 - Mos emërimi i zyrtarit certifikues

Gjetja Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë neni 14.1. thekson se çdo organizatë buxhetore, agjenci autonome ekzekutive dhe ndërmarrje publike duhet të ketë Zyrtarin Certifikues. Zyrtari Certifikues emërohet dhe i raporton Zyrtarit Kryesor Administrativ. Përgjegjësia e tij është të sigurojë që kushtet e zbatueshme të një kontrate publike të jenë përmbushur para bërjes ose autorizimit të pagesave sipas kontratës.

KRU Hidromorava asnjëherë deri më tash nuk e kishte të mbuluar pozitën e zyrtarit certifikues dhe si rrjedhojë e kësaj pagesat ishin aprovuar nga zyrtari kryesor financiar dhe Kryeshefi Ekzekutiv.

Shkak i mos emërimit të zyrtarit certifikues sipas zyrtarëve të kompanisë ishin se ndërmarrja ishte ballafaquar me vështirësi financiare në vitet e fundit dhe nuk kishte buxhet për rekrutimin e zyrtarit certifikues.

Ndikimi Mos emërimi i zyrtarit certifikues përveç që është një mangësi në plotësimin e pozitave të parapara me ligj, rritë rrezikun që pagesat të cilat ekzekutohen nga Kompania, të mos i nënshtrohen kontrollit të duhur, dhe si të tilla, të bëhen jo konform kërkesave ligjore.

Rekomandimi A8 Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë funksionalizimin e pozitës së zyrtarit certifikues me përgatitje adekuate, i cili ushtron funksionin e tij dhe siguron aplikimin efektiv të rregullave të kontrollit dhe menaxhimit financiar para se pagesat të jenë kryer.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Prokurime të shpeshta me vlera minimale

Gjetja Rregullat dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (RRUOPP), neni 5, thekson se përgatitja e planit vjetor të prokurimit: eliminon nevojën për prokurime emergjente apo përjashtime, mbledhë kërkesat kur është e mundshme për të fituar vlerën për paranë, mundëson identifikimin e kontratave kornizë dhe eviton ndarjen e kërkesave të prokurimit që janë kryesisht të njëjta ose të ndërlidhura.

Gjithashtu, sipas RRUOPP, autoriteti kontraktues mund të përdor procedurën me vlerë minimale për çdo kontratë publike vlera e përlogaritur e të cilës është më pak se 1,000€. Me dhënien e porosive për blerje në lidhje me prokurimin me vlerë minimale, autoriteti kontraktues do të sigurojë një konkurrim efektiv, transparencë dhe efektivitet të lartë të përdorimit të fondeve publike.

Kompania gjatë vitit 2021 kishte nënshkruar gjithsej 87 kontrata publike prej tyre 70 kontrata ishin nënshkruar sipas procedurës për kontrata me vlerë minimale. Përdorimi kaq i shpeshte i procedurës me vlerë minimale në raport me procedurat tjera të hapura zbehet transparencën dhe konkurrueshmërinë duke mos siguruar vlerën për parinë.

Ndarja e kërkesave ka rrjedhur si rezultat i mos identifikimit të nevojave për furnizime me kohë dhe planifikimit të dobët dhe jo të duhur të sasisë për këto furnizime.

Ndikimi

Ndarjet dhe shmangiet e procedurave të përshtatshme të prokurimit reflektojnë me mungesë transparence dhe kufizim të konkurrencës, duke rrezikuar edhe aspektin kualitativ të furnizimeve të pranuar për parinë e shpenzuar.

Rekomandimi B4

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se bëhet identifikimi i nevojave për furnizime nga të gjitha njësitë kërkuuese, dhe të njëjtat përfshihen në planin vjetor të prokurimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020 ka rezultuar në 17 rekomandime. Kompania ka përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, 13 rekomandime janë zbatuar ndërsa 4 nuk janë adresuar ende.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 1.

Grafiku 1. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 1 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2021

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se, bëhet klasifikimi i duhur i zërave në kontabilitet dhe njëkohësisht zëri i shpenzimeve të prezantohet drejtë në PFV në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.	Janë kryer korrigjimet e nevojshme dhe gjatë testeve të këtij viti nuk kemi hasur raste tjera të keqklasifikeve të shpenzimeve.	I zbatuar

2.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se në regjistrin e pasurisë janë të regjistruara vetëm vlerat neto të tyre pa përfshirjen e tatimeve të rimbursueshme nga autoritetet përkatëse tatimore, dhe po ashtu të sigurojë që janë marrë veprimet korrigjues të vlerës së pasurive të mbivlerësuara.	Janë kryer korrigjimet e nevojshme kontabël në lidhje me korrigjimin e TVSH-së për rastin e blerjes së pasurive afatgjata dhe gjatë testimit nuk kemi vërejtur mangësi me rastin e regjistrimeve të blerjeve të reja të vitit.	I zbatuar
3.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme për të regjistruar saktë vlerën e financimeve nga grantet dhe të bëhet një rishikim i shumave para miratimit të tyre me qëllim që prezantimi i PFV-ve të jetë i plotë dhe i drejtë.	Kompania nuk kishte arritur të kryej korrigjimet e nevojshme për mos përputhjet e identifikuar në vitin paraprak. Edhe këtë vit ka mospërputhje në mes shënime analitike dhe vlerës së detyrimit ndaj grantit të prezantuar në pasqyrat financiare.	Nuk ka filluar zbatim
4.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se në saldon e investimeve në vijim përfshihen vlerat e sakta duke përjashtuar vlerat e TVSH-së në prezantimin e këtij zëri. Po ashtu, të marrë veprime korrigjuese për regjistrimet e identifikuar me gabime.	Janë kryer korrigjimet e nevojshme kontabël në lidhje me korrigjimin e TVSH-së për investimet në vijim dhe gjatë testimit nuk kemi vërejtur mangësi me rastin e regjistrimeve të investimeve në vijim.	I zbatuar
5.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se në vazhdimësi është duke u bërë harmonizimi i daljeve fizike të stokeve me regjistrat kontabël në mënyrë që të shmangen diferencat të cilat janë paraqitur mes shënimeve kontabël dhe evidentimit fizik të stokut dhe të prezantohet vlera e saktë e stokeve në PFV.	Janë kryer korrigjimet e nevojshme kontabël dhe gjatë testimit të këtij viti nuk kemi vërejtur mangësi në harmonizimet e daljeve nga depo me regjistrat kontabël.	I zbatuar

6.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë një rishikim gjithëpërfshirës të regjistrit të pasurisë dhe të ndër marrë veprime konkrete për rivlerësimin dhe rishikimin e jetës së dobishme të pasurive së paku një herë në pesë (5) vite. Kjo me qëllim të paraqitjes së vlerës reale të pasurive, në përputhje me kërkesat e SNK 16.	Menaxhmenti ende nuk kishte arritur të kryej rivlerësimin e pasurive afatgjata.	Nuk ka filluar zbatim
7.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se regjistrimi i stoqeve bëhet në pajtim me politikat kontabël, bëhet rishikimi dhe harmonizimi i rezultateve të tyre dhe prezantohen drejtë në PFV.		Nuk ka filluar zbatim
8.	Kontrollet e brendshme në raportimin financiar	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar harmonizimin e shënimeve në mes të departamenteve dhe të sigurojë korrigjimin e gabimeve në saldon e llogarive të arkëtueshme dhe në pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme.	Janë kryer harmonizimet e nevojshme në mes të departamenteve si dhe është bërë korrigjimi e saldosh të llogarive të arkëtueshme e bartur tek pasqyra e rrjedhës së parasë.	I zbatuar
9.	Llogaritë e arkëtueshme	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme korrigjuese për harmonizimin e të dhënave ndërmjet modulit të shitjes me modulën e kontabilitetit, në mënyrë që të sigurohet informacioni i saktë i vlerës së llogarive të arkëtueshme.	Janë kryer harmonizimet e nevojshme në mes të modulit të shitjes dhe modulit të kontabilitetit.	I zbatuar
10.	Pasuritë afatgjata	Bordi i Drejtorëve të sigurojë që të ndërmerren veprimet e nevojshme në menaxhimin dhe realizimin e projekteve për investime kapitale, në mënyrë që ekzekutimi i punëve të realizohet brenda afateve të parapara kohore.	Përmes testimit të procedurave të vitit 2021 nuk kemi vërejtur vonesa në projektet kapitale.	I zbatuar
11.	Pasuritë afatgjata	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se janë marrë të gjitha veprimet e nevojshme për korrigjimin në rexhistrën kontabël dhe gjithashtu lidhja e kontratave të bëhet vetëm sipas udhëzuesve të KRPP-së.	Janë kryer korrigjimet e nevojshme kontabël dhe gjatë testimit nuk kemi vërejtur përsëritje të kësaj çështje.	I zbatuar

12.	Pasuritë afatgjata	Bordi i Drejtorëve të sigurojë marrjen e veprimeve korigjuese në mënyrë që të gjitha regjistrimet e faturave të bëhen në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit.	Janë kryer korigjimet e nevojshme kontabël dhe gjatë testimit nuk kemi vërejtur gabime në regjistrimin e faturave të blerjeve të pasurisë.	I zbatuar
13.	Pasuritë afatgjata	Bordi i Drejtorëve të sigurojë marrjen e veprimeve të nevojshme për sanimin e dëmeve dhe funksionalizimin e pikës së furnizimit me ujë.	Janë ndërmarrë veprimet e nevojshme nga Menaxhmenti për ri funksionalizimin e pikës së furnizimit me ujë.	I zbatuar
14.	Detyrimet afatshkurta	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se vlera e detyrimeve të njihet dhe prezantohet saktë në PFV si dhe të marrë masat e nevojshme korigjuese të gabimeve në lidhje me detyrimet në të dhënat kontabël.	Nga testimi i detyrimeve nuk kemi hasur në pasaktësi	I zbatuar
15.	Të hyrat	Bordi i Drejtorëve të sigurojë krijimin e një komisioni të brendshëm i cili do të bëjë identifikimin e konsumatorëve dhe mbylljen e llogarisë pezull. Rrjedhimisht, konsumatorët të cilët i kanë paguar obligimet e tyre dhe mjetet e të cilëve janë në llogarinë "Pagesa të paidentifikuara" të ju zbriten klientëve nga kartelat e tyre individuale.	Menaxhmenti ka arritur të zvogëloj saldon e llogarisë pezull për konsumatorët e pa identifikuar dhe është duke bërë përpjekje të mbyll krejtësisht ne zero.	I zbatuar
16.	Shpenzimet operative	Bordi i Drejtorëve duhet të siguroj që zyra e financave regjistrojnë transaksionet në mënyrë të drejtë duke interpretuar drejtë standardet e kontabilitetit.	Janë kryer korigjimet e nevojshme dhe gjatë testimeve të këtij viti nuk kemi hasur ne përsëritje të kesaj çështje.	I zbatuar
17.	Shpenzimet operative	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se bëhet identifikimi i nevojave për furnizime nga të gjitha njësitë kërkuese dhe të njëjtat përfshihen në planin vjetor të prokurimit. Përpilimi adekuat i planeve për furnizime ndihmon në zhvillimin e procedurave adekuate dhe shtim të vlerës për para.	Edhe kete vit ndërmarrja kishte numër shumë të lartë prokurimeve përmes procedurave për kontratat me vlerë minimale.	Nuk ka filluar zbatimi

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Qerkin Morina, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Mehmet Mucaj, Drejtor i Auditimit



Naim Neziri, Udhëheqës i ekipit



Alban Shatri, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



No. 730 Data 02.06.2022
GJILAN

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjetë Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësajshkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit Hidromoravës sh. a., për vitin 2021 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

z. Habil Zeqiri



Kryesues i Bordit të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit Hidromorava sh. a.

Data: 01.06.2022

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante.
- ² Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet